



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 387/6 Prot.

Tiranë, më 29.07.2016

V E N D I M

Nr. 99, datë 29.07.2016

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 387/1 prot, datë 26.05.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, i lejuar të aplikohet sipas nenit 185, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Bashkisë Tropojë, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 387/1 prot, datë 26.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së aktit administrativ nr. 46/3, datë 18.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, i cili bazohet në vendimin nr. 46/2, datë 13.04.2016, të Komisionit Disiplinor pranë kësaj Bashkie, *“Për largimin nga shërbimi civil të nëpunëses *****, si Përgjegjëse e zyrës së financës, në Njësinë administrative Margegaj”*.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 387/2, datë 26.05.2016, është vënë në dijeni Bashkia Tropojë, për fillimin e këtij verifikimi, si dhe është kërkuar nga institucioni, dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e tij.

Nga përmbajtja e kërkesës së nëpunëses *****, nr. 387 prot., datë 12.05.2016, rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 387 prot., datë 26.05.2016, si edhe shkresës së Bashkisë Tropojë, me nr. 2262/1 prot., datë 01.06.2016 *“Kthim Përgjigje”*, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit

Civil, me nr. 387/5 prot., datë 03.06.2016, rezulton se, punonjësja ***** është emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, pranë Komunës Margegaj, në datën 01.03.2008. Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, me të drejtë, nga Njësia e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 26/4 prot., dt.26.04.2015, punonjësja ***** është deklaruar nëpunëse civile, në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, pranë Komunës Margegaj.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Bashkia Tropojë, me anë të shkresës nr. 1959, dt. 09.11.2015, i ka kërkuar punonjësës ***** dorëzimin e të gjithë dokumentacionit financiar të ish Komunës Margegaj.

Në vijim të këtij hetimi, evidentohet fakti se punonjësja ***** për arsye shëndetësore ka qenë me raport mjekësor, nga data 10.09.2015, deri në datën 07.03 2016 (pra 6 muaj).

Për dorëzimin e rregullt të dokumentacionit të kërkuar, në zbatim të Vendimit nr. 510 datë 10.06.2015, kreu 5, pika 3 dhe kreu 6, pika 2, të Këshillit të Ministrave, me shkresën nr. 3066 datë 30.12.2015, është kërkuar që kjo punonjëse të jetë prezent në njësinë administrative Margegaj, ose të dërgojë një përfaqesues, për të asistuar në tërheqjen e dokumentacionit financiar.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, gjatë kësaj kohe punonjësja ***** është njohur me kërkesat e vazhdueshme të Bashkisë Tropojë, dhe nuk ka marrë asnjë masë për zgjidhjen e këtij problemi (pra, dorëzimin e rregullt të dokumentacionit teknik).

Në këto kushte, Kryetari i Bashkisë Tropojë, ka krijuar komisionin e marrjes në dorëzim për arkivim të dokumentacionit në njësinë administrative Margegaj, me Urdhrin nr. 2, datë 05.01.2016 .

Në vijim të këtij procesi, Kryetari i Bashkisë Tropojë, ka nxjerrë Urdhrin nr. 6, datë 07.01.2016, “ Për ngritjen e komisionit të shqyrtimit dhe inventarizimit të dokumentacionit financiar, të njësisë administrative Margegaj”. Sipas këtij akti, materiali përfundimtar i përgatitur nga komisioni do të paraqitet pranë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, me një relacion, brenda datës 15.01.2016.

Pas kësaj me shkresën nr. 624, datë 10.02.2016, punonjësja ***** është njoftuar për mungesat e konstatuara në dokumentacion, pas kryerjes së inventarizimit dhe i është kërkuar që, nëse disponon dokumentacion tjetër, ta dorëzojë pranë Drejtorisë Ekonomike.

Nga verifikimi, nuk rezulton që kjo punonjëse t'i ketë kthyer përgjigje Bashkisë Tropojë, apo të ketë dorëzuar ndonjë dokumentacion plotësues, sipas kërkesës së këtij institucioni.

Në vijim, në zbatim të Urdhrit nr. 6, datë 07.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë, Komisioni i shqyrtimit dhe inventarizimit të dokumentacionit financiar në Njësine Administrative Margegaj, ka paraqitur një informacion me nr.1365/8, datë 24.03.2016, ku evidenton mungesa të shumta në

dokumentacion, të tilla si, strukturat organizative të administratës për vitet 2014-2015, Vendimet e Këshillit të Komunës për emërimet e punonjësve të administratës, listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe akte të tjera që kanë lidhje me rastin në fjalë.

Gjithashtu nga përmbajtja e raportit mjekësor nr. 22, datë 11.02.2016, rezulton se kjo punonjëse, duhej të paraqitej në punë në datën 08.03.2016, pasi i kishte përfunduar afati i raportit. Në vijim, sipas pohimit të vetë institucionit, punonjësja është paraqitur në punë, pranë Njesisë Administrative Margegaj, në datën 23.03.2016 pra, pas 10 (dhjetë) ditë pune, mungesë të paarsyeshme.

Në këto kushte, punonjësja i është kërkuar që të paraqitej pranë Bashkisë Tropojë, si institucioni punëdhënës, por ajo nuk rezulton ta ketë zbatuar këtë kërkesë, nga data 08.03.2016, deri në datën 18.04.2016, me pretendimin se ishte duke kryer lejen vjetore.

Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 85, datë 01.10.2015, pika 5, *“Drejtorët dhe Administratorët lejohen për tu dhënë leje vartësve jo më shumë se një ditë”* dhe pika 6, *“Lejet e zakonshme do të planifikohen nga Drejtorët dhe Administratorët e njësive për punonjësit e varësisë dokument i cili do të dorëzohet në Degën e Personelit brenda muajit janar 2016”*, nuk konstatohet që kjo punonjëse, të ketë bërë ndonjë kërkesë për të kryer lejen vjetore dhe rrjedhimisht në institucion, nuk ka ndonjë shkresë për miratimin e saj.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, prej datës 08.03.2016 deri në datën 18.04.2016, punonjësja *******, ka munguar në punë, duke pretenduar se po kryen lejen vjetore të vitit 2015 (*përfashtuar këtu datën 23 kur është paraqitur në njësinë administrative Margegaj, datën 08.04.2016 dhe datën 13.04.2016, që ka marrë pjesë në komisionin disiplinor*). Këtë veprim kjo punonjëse e ka bërë me iniciativën e vet, pa marrë aprovimin tek drejtuesi i Bashkisë Tropojë.

Konstatohet se, mbështetur në faktin e thyerjes së disiplinës, për mos paraqitjen në punë dhe nga informacioni i komisionit të inventarizimit, për mungesat e evidentuara në dokumentacionin financiar që është tërhequr nga kjo njësi administrative, Njësia e Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 1364/5 prot., datë 29.03.2016, bazuar në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, neni 59, pika 3,4, gërma b dhe c, si edhe VKM nr.115 datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, kreu II, pika 2, ka kërkuar fillimin e procedurës disiplinore, ndaj nëpunëses civile *******, me arsyetimin se ndodhej para shkeljeve shumë të rënda disiplinore, si dhe mospërmbushjes së detyrave funksionale.

Për trajtimin e kësaj kërkesë, me Urdhrin Nr. 68, dt. 24.03.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, është ngritur Komisioni Disiplinor, i cili pasi është njohur me kërkesën dhe materialin e paraqitur nga njësia e burimeve njerëzore, me Vendimin nr. 46, datë 29.03.2016, ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunëses ******* *“Për shkelje shumë të rënda të disiplinës në punë”*, duke caktuar si seancë dëgjimore, datën 08.04.2016, ora 12.00.

Me këtë vendim të Komisionit të Disiplinës, kjo punonjëse është njoftuar me anë të shkresës nr. 1365 prot., dt. 29.03.2016.

Gjatë hetimit administrativ të kryer prej Komisionit Disiplinor, është paraqitur një informacion nga ana e Drejtorisë Ekonomike, me nr. 1502 prot., datë 07.04.2016, në të cilin, sipas hartuesve

të tij, janë evidentuar shkelje të rënda në kryerjen e detyrave funksionale prej punonjësës së proceduar, të cilat kanë sjellë për pasojë një dëm të madh ekonomik për institucionin.

Në vijim, rezulton se Komisioni Disiplinor ka zhvilluar mbledhjen sipas datës së përcaktuar prej tij, në prezencë edhe të punonjësës ******, duke i dhënë mundësinë të jepte shpjegime mbi shkeljet e konstatuara. Gjithashtu, asaj i është vënë në dispozicion edhe informacioni nr. 1502 prot., datë 07.04.2016, së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe relacionin për detyrimet e pashlyera etj., si dhe llogaritjen e dëmit financiar që i është shkaktuar Bashkisë Tropojë.

Pas dëgjimit të pretendimeve të kësaj punonjëseje, se sapo ishte njohur me materialet e vëna në dispozicion dhe kërkonte një afat të arsyeshëm për shqyrtimin e tyre dhe përgatitjen e mbrojtjes, Komisioni i Disiplinës me Vendimin nr. 46/1 datë 08.04.2016, ka vendosur, shtyrjen e seancës së shqyrtimit në datën 13.04.2016, duke i kërkuar që pretendimet e saj të jenë të përgatitura me shkrim.

Me tej, rezulton se, Komisioni Disiplinor në datën 13.04.2016, ka përfunduar seancën dëgjimore për këtë rast dhe në përfundim, me Vendimin nr. 46/2, datë, 13.04.2016, në bazë të gërmës “ç” të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur “Largimin nga shërbimi civil” të nëpunësës ******, për shkelje të rëndë të disiplinës në punë, e cila ka konsistuar në shkaqet e mëposhtme:

1. Mosrespektim i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda për institucionin, në shkelje të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 57, pika 2, gërma b.
2. Moszbatim i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 57, pika 2, gërma c, ku me veprimet apo mos veprimet e saj, ka sjellë një dëm të madh ekonomik ndaj institucionit.
3. Mosparaqitje në punë për një periudhë prej më shumë se një muaj, pa arsye apo shkaqe objektive, në shkelje të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 57, pika 2, gërma ç, si dhe aktit administrativ, nr. 85, datë 01.10.2015, të Bashkisë Tropojë.

Bazuar në vendimin e mësipërm të Komisionit të Disiplinës, Kryetari i Bashkisë Tropojë, ka nxjerrë Vendimin nr. 46/3, datë 18.04.2016, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe largimin nga detyra të nëpunësës ******, vendim i cili i është njoftuar të interesuarës me shkresën nr. 1365 prot., datë 18.04.2016.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrij në përfundimin se gjithë aktet administrative që kanë dalë për konstatimin e shkeljeve të ndryshme të disiplinës të punonjësës ******, procedura e ndjekur që me fillimin e ecurisë disiplinore, ngritjen e Komisionit Disiplinor, kalimin e çështjes për trajtim në Komisionin e Disiplinës, marrjen e masës disiplinore me Vendimin Nr. 46/2, datë 13.04.2014, të Komisionit Disiplinor të Bashkisë Tropojë, “Për largimin nga shërbimi civil i nëpunësës *****”, dhe Vendimin nr. 46/3, datë 18.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për ndërprerjen e marrëdhënies të punës së kësaj punonjëse, janë akte të nxjerra konform procedurës dhe kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këto rrethana vlerësoj se veprimi administrativ i mësipërm dhe aktet që e kanë shoqëruar atë, janë nxjerrë në përputhje me ligjin, prandaj nuk është i nevojshëm investimi apo ndërhyrja, e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rregullimin e ligjshmërisë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika 6, dhe 34, pika 1, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ, kryer mbi bazën e Urdhrit të Verifikimit nr.387/1 prot., datë 26.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për verifikimin e informacionit në lidhje me, ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil të punonjësës *****, në Bashkinë Tropojë”.
2. Të njoftohen për këtë vendim ***** dhe Bashkia Tropojë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA